

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: (Spitali i përgjithshëm "Dr.Sami Haxhibeqiri" – Mitrovicë)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:(70040-19-2793-121)

Sa i përket tenderit për(Furnizim me Paisje Mjeksores (5.Llote)) PËR LOT 2 DHE LOT 3

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

KosovaMed Healthcare sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.B (Kompleksi Royal), Muharrem Fejza, Hyrja C15/13, Nr.4, Prishtinë, Republika e Kosovës

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

049 725 444

(Numri Telefonit)

10.000

(Kodi postar)

N/A

(Numri i Faks-it)

Kastriot Asllani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

kastriot.asllani@kosovamed-hc.com

(Adresa elektronike)



13.06.2019

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë”apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

06.05.2019 Njoftimi për Kontratë
13.05.2019 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara
30.05.2019 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara
10.06.2019 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara
22.05.2019 Kërkesa për Ri-shqyrtim dërguar AK-së
24.05.2019 E-maili i AK-së për vazhdim të afatit të kthimit të përgjigjes në ri-shqyrtim
24.06.2019 Vendimi i AK-së për ri-shqyrtim
30.05.2019 Kërkesa për Ri-shqyrtim dërguar AK-së
31.05.2019 E-maili i AK-së për vazhdim të afatit të kthimit të përgjigjes në ri-shqyrtim
05.06.2019 Vendimi i AK-së për ri-shqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Ende nuk është bërë hapja e tenderit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së Operatori ekonomik KosovaMed Healthcare sh.p.k. ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim.

Gjeni bashkangjitur dy Kërkesat për Ri-shqyrtim dërguar AK-së:

22.05.2019 Kërkesa për Ri-shqyrtim dërguar AK-së

30.05.2019 Kërkesa për Ri-shqyrtim dërguar AK-së

05.06.2019 Përgjigja e AK-së

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 - Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminim

Neni 28.2 - Specifikimet teknike

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejtari fën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

OE "KosovaMed Healthcare" sh.p.k., si palë e interesuar me aktivitetin e prokurimit:

Spitali i përgjithshëm "Dr.Sami Haxhibeqiri" – Mitrovicë

Nr i Prokurimit 70040-19-2793-1-2-1

Nr i brendshëm 70040-19-011-121

Furnizim me Paisje Mjeksores (5.Llote)

GRUPI 2. FURNIZIM ME PAISJE PER FUNKSIONALIZIMIN E ARTROSKOPIT PER REPARTIN E ORTOPEDISË.

GRUPI 3. FURNIZIM ME PAISJE PER FUNKSIONALIZIMIN E RESEKTOSKOPIT DHE URETHROTOMIT PER REPARTIN E UROLOGJISË

Të nderuar, në afatet ligjore kemi bërë ankesë (22.05.2019 kërkesë për rishqyrtim) në AK – Spitali i përgjithshëm “S.Haxhibeqiri” – Mitrovicë sipas nenit 108/A.

Të funksjonalizimi i shtyllës së Artroskopit ku kemi vërejtur të GRUPI 2 se pjesët e kërkuara nuk janë për prodhuesin Storz siq është pretenduar në dosje të tenderit dhe në specifika teknike por shtylla ekzistuese që gjendet në Spitalin e Mitrovicës është Richard Wolf, pas kërkesës sonë për rishqyrtim me argumentet që i kemi dorëzuar dhe pasi e kanë verifikuar gjendjen ekzistuese të Artroskopit në Repartin e Ortopedisë, si dhe

GRUPI 3 Resektoskopit dhe Urotomit në repartin e Urologjisë në Spital, AK ka ndryshuar titullin në dosje të tenderit dhe ka shtuar +15% variacion në specifikim teknik.

Por ende kanë mbetur specifikimet teknike sipas prodhuesit Karl Storz. Kjo na pamundëson pjesëmarrjen në këto kushte si dhe zgjedh direkt fitues OE që reprezenton Karl Storz në Kosovë. Kemi kërkuar nga AK anulimin e lotovë të lartëpërmendura dhe të ri-shpallen këto lloje me specifika të duhura për paisjen ekzistuese, por AK ka ndërruar vetëm Nën-Titullin.

PROV: Kërkesa për rishqyrtim dërguar AK-së me datë 22.05.2019

Të nderuar, në afatet ligjore kemi bërë ankesë (30.05.2019 kërkesë për rishqyrtim) në AK – Spitali i përgjithshëm “S.Haxhibeqiri” – Mitrovicë sipas nenit 108/A.

Grupi 2 Furnizim me pajisje për funksionalizimin e Artroskopit për repartin e Ortopedisë.

Grupi 3 Furnizim me pajisje për Funksionalizimin e Resektoskopit dhe urethrotomit për repartin e Urologjisë.

AK ka bërë ndryshim sa i përket përshkrimit por jo të specifikat teknike:

“Sqarim: Paisja ekzistuese është Richard wolf, në këto lloje specifikat e kërkuara të jenë kompatible – ekuivalente me shtyllën ekzistuese. Lista e instrumenteve dimensionet mund të kenë variacion +/- 15%.”

Ne si OE, të specializuar dhe distributor të prodhuesit Gjerman Richard Wolf, kemi shquar me kujdes specifikimin teknik të këtyre dy lotovë.

Është shqetësues fakti që për pajisjen që ju e keni “Richard Wolf” keni kërkuar pjesë të përpiluara eksklusivisht për Karl Storz !

Pra dhe më shumë na shqetëson fakti që për Grupi1 “Furnizim me pajisje shtesë për sistemin ekzistues FESS të prodhuesit Karl Storz dhe pajisje tjera për ORL”

Ju përdorni standartin e rregullt dhe profesional për pjesë shtesë ose për funksionalizim të drejtë dhe të saktë që për Pajisjen ekzistuese Karl Storz të sigurohen pjesët adekuate, por tek Grupi 2 dhe Grupi 3 nuk e aplikoni formën e njëjtë dhe obligative të kërkesës së pjesëve Originale për Richard Wolf por e leni të lajthitur, e kemi cekur që më e keqja është se i vendosni pjesë Karl Storz për aparatit Richard Wolf! Duke rrezikuar të gjitha këto mjete të shpenzohen kot dhe njëherit OE Profesional të Autorizuar nga Richard Wolf e përjashtoni padrejtësisht nga ky aktivitet. Ju informojmë për rrezikun që këto pajisje nuk do përshtaten dhe rrezikoni operacionet dhe diagnostikën që kryhet në këto salla me këto specifika! Fjalët “kompatible – ekuivalente” nuk përkojnë me kirurgjinë laparoskopike aq më pak kur vendosen pjesë jo origjinale RICHARD WOLF të blehen dhe të rrezikohet pacienti poashtu buxheti i taksapaguesve të Republikës së Kosovës.

Kemi kërkuar nga titulli i lartëpërmendur AK-Spitali Mitrovicës:

Lloji 2. Furnizim me pajisje për funksionalizimin e Artroskopit për repartin e Ortopedisë

- Të kërkohej (ndryshohet siq është kërkuar në grupin 1) në Furnizim me pajisje shtesë për Artroskopinë në Repartin e Ortopedisë – Richard Wolf

- Të kërkohej vërtetimi i prodhuesit RICHARD WOLF – Original për pjesë origjinale

- Të përpilohen (ndryshohen komplet) specifikat – pjesët Originale për Richard Wolf dhe jo specifikim i pasakte, qofte nga Njesia Kerkuese ose nga ekspertat e SHSKUK.

-Të largohet +/- 15% variacioni sepse është e pasaktë në pajisje të fushës së tillë!

Lloti 3. Furnizim me pajisje për funksionalizimin e Resektoskopit dhe urethrotomit për repartin e Urologjisë

- Te kërkohet (ndryshohet siq është kërkuar në grupin 1) në **Furnizim me pajisje shtes për funksionalizimin e Resektoskopit dhe urethrotomit për repartin e Urologjisë – Richard Wolf**
 - Te kërkohet vërtetimi i prodhuesit RICHARD WOLF – Original për pjesë origjinale
 - Te përpilohen (ndryshohen komplet) specifikat – pjesët Origjinale për Richard Wolf dhe jo specifikim i pasaktë, qoftë nga Njesia Kërkuese ose nga ekspertat e SHSKUK.
 - Të largohet +/- 15% variacioni sepse është e pasaktë në pajisje të fushës së tillë !
- Ne kërkojmë sikurse kanë kërkuar AK të LOT 1 specifikisht për Storz, po ashtu të kërkojnë për LOT 2 dhe LOT 3 specifikat për Wolf, por përkundër kërkesave tona për ri-shqyrtim LOT2 dhe LOT3 ende mbeten të përshtatur për një prodhues Karl Storz.

Kërkojmë rregullimin e kërkesave dhe titullit të lotove të lartëpërmendura dhe të ri-shpallen keto lloje me specifika të duhura dhe të hapura për të gjithë operatorët, nuk po kërkojmë më shumë se sa siq e keni bërë në Grupi 1 apo LOT1.

PROV: Kërkesa për rishqyrtim dërguar AK-së me datë 30.05.2019

Ne si Operator Ekonomik Kërkojmë nga ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK që të bëhet trajtimi i barabartë i OE në secilin lot dhe tenderin në fjalë ta ktheni në **RI-TENDER**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kemi dëme materiale si dhe mohohet e drejta jonë duke u shkelur LPP-së nga ana e autoritetit kontraktues.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.**